

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Analiza ekonomike e së drejtës
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti IV, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla D3
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Mejdi Bektashi
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:mejdi.bektashi@uni-pr.edu">mejdi.bektashi@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p><i>Studimi i lëndës “Analiza ekonomike e së drejtës” është një hyrje e përgjithshme mbi njohuritë dhe metodat e shtjellimit të shkencës ekonomike. Të kuptohet se e drejta ka ndikim të veçantë dhe të fuqishëm, por nga ana tjetër dhe parashikues në karakterin e jetës dhe aktiviteteve ekonomike dhe se nga ana tjetër se e drejta zhvillohet dhe modifikohet si përgjegjje ndaj ndryshimeve të pandërprera ekonomike.</i></p> <p><i>Ky kurs do të fokusohet në zbatimin e ekonomisë në fushën e të drejtave pronësore, konkurrencës, korporatave, falimentimit dhe të drejtës së kontratave, dëmit etj. dhe po ashtu, do të eksplorojë se si ekonomia mund të përdoret për të kuptuar funksionimin e vetë sistemit juridik. Studentët do të marrin një përmbledhje të të gjithë analizës ekonomike të së drejtës, njohuri të vlefshme ekonomike përgjithësisht të teorisë dhe praktikës.</i></p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p><i>Qëllimi i studimit të kësaj disipline ekonomiko-juridike, dhe shumë aktuale është që studenëtve t’iu ofrojë njohuri thelbësore e të mjaftueshme por njëkohësisht dhe aktuale lidhur me proceset më aktuale në fushën e ndërlidhjes së drejtësisë dhe ekonomisë.</i></p> <p><i>Qëllimi i mësimit të lëndës analiza ekonomike e së drejtës është që të ju mundësoj studentëve që të kuptojnë ndërlidhjen sistematike në mes drejtësisë dhe ekonomisë, të kuptojnë aplikimin e teorisë ekonomike në tërësinë e sistemit juridik, mënyrën e veprimit të ligjeve dhe vendimeve gjyqësore si dhe mënyrën dhe metodat e alokimit të resurseve, rregullimin ekonomik, aplikimin e teorisë ekonomike në vendimarrjen politike dhe në vendimet për zgjedhjen e rregullativës ligjore dhe politikës ligjore.</i></p> <p><i>Ekonomia është një mjet jashtëzakonisht i fuqishëm për të analizuar një gamë të gjerë të çështjeve juridike, rregullave dhe institucioneve. Analiza ekonomike e së drejtës është një</i></p>

	<i>lëndë interdisiplinore që ndërthur në vete dy fusha kryesore të studimit (drejtësia dhe ekonomia) dhe po ashtu, siguron një kuptim më të mirë të të dyjave. Ekonomia i ndihmon studentët që të perceptojnë ligjin në një mënyrë të re, më inovative, por dhe më të dobishme.</i>		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<i>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë të aftësuar që:</i> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>a) t'i kuptojnë dhe shpjegojnë nocionet parësore dhe principet e analizës ekonomike të së drejtës;</i></li> <li><i>b) në mënyrë kritike ta vështrojnë sistemin juridik, institutet dhe rregullat e veçanta juridike, duke përdorur argumentet dhe logjikën ekonomike;</i></li> <li><i>c) t'a vështrojnë të drejtën përmes ndërlidhjes me problemin e stimulimit, distribuimit të riskut, vlerësimit të kostove dhe dobive;</i></li> <li><i>d) të bëjnë dallimin në mes konceptit të drejtshmërisë dhe efikasitetit;</i></li> <li><i>e) t'i përdorin njohurit e fituara në praktikë, në veçanti në rrolin e gjykatësit, prokurorit, avokatit, noterit, menaxherit etj.</i></li> </ol>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	4	16
Përgaditja përfundimtare për provim	6	2	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>100 orë</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<i>Me anë të ligjëratarave, prezentimeve, seminarëve, punës në grupe, testëve dhe formave tjera të mësimdhënies dhe vlerësimit te njohurive gjatë gjithë semestrit, studentët do të aftësohen që në të ardhmën, në mënyrë të pavarur dhe në cilësinë e ekspertit profesional t'i sfidojnë situatat që</i>		

	<i>paraqiten në fushën e marrjes së vendimeve ekonomike, financiare dhe atyre juridike.</i>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja e rregullt në ligjëratat, dhe debate: 10%</li> <li>• Pjesëmarrja në prezantime: 10%</li> <li>• Punimi seminarik me shkrim dhe i mbrojtur: 20%</li> <li>• Provimi përfundimtarë: 60%</li> <li>• <b>Gjithsejt: 100%</b></li> </ul>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Ligjerata të autorizuara të mësimdhënësit.</i></li> <li>2. <i>Richard Posner: Economic Analysis of Law, Little, Brown and Company, London 1992.</i></li> <li>3. <i>Steven Shavell: Foundations of Economic Analysis of Law, Harvard University Press, 2009.</i></li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Todd G. Buchholz: Ide të gjalla nga ekonomistë të vdekur, ISP &amp; Dita 2000, Tiranë, 2009.</i></li> <li>2. <i>Bouckaert, B., De Geest, G.: "Encyclopedia of Law and Economics", <a href="https://users.ugent.be/~gdegeest/tablebib.htm">https://users.ugent.be/~gdegeest/tablebib.htm</a>.</i></li> <li>3. <i>Van den Bergh, R., Camesasca, P.: "European competition Law and Economics", 2nd edition, Sweet &amp; Maxwell, 2006.</i></li> <li>4. <i>Cooter, R., Ulen, T.: "Law and Economics", 5th edition, Addison-Wesley, 2008.</i></li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Ekonomia dhe drejtësia; Analiza ekonomike e krimit; e drejta e detyrimeve; Ligji antitrust; Metodat dhe nocionet themelore të analizës ekonomike të së drejtës; Vlera, përdorshmëria, dobia, kosto dhe efikasiteti; Ekonomia e sjelljes, irracionaliteti dhe racionaliteti.
<b>Java e dytë:</b>	Nocionet fundamentale ekonomike dhe principet e rëndësishme për analizën ekonomike të së drejtës; nocioni i resurseve dhe kufizimi i tyre; Ekonomia është shkencë mbi zgjedhjen racionale; Oferta dhe kërkesa si instrumente të analizës ekonomike; Liria dhe përgjegjësia; E drejta si subjekt i analizës ekonomike. Efikasiteti dhe drejtësia.
<b>Java e tretë:</b>	Zbatimi i Analizës ekonomike të së drejtës në praktikë; Ekonomia institucionale; Teorema e Ronald Coase; E drejta e vjetër dhe ekonomiksi; E drejta e re dhe ekonomiksi; Institucionet, e drejta dhe ekonomiksi.
<b>Java e katërt:</b>	Kostot (Shpenzimet) transaksionale; Matja e kostove transaksionale; Llojet e kostove transaksionale dhe rëndësia e tyre; Ligjet dhe kostot transaksionale.
<b>Java e pestë:</b>	Institucionet dhe Analiza ekonomike e së drejtës; Rëndësia e institucioneve nga këndvështrimi i AED; Ligjet dhe kostot e transaksionit.
<b>Java e gjashtë:</b>	Rëndësia e pronës nga këndvështrimi i AED; Prona në të drejtën

	dhe ekonomiks; Karakteristikat e pronës private; Bartëshmëria; Kufizimi i pronës private; Pronësia kolektive dhe karakteristikat; Pronësia shoqërore; Pronësia shtetërore; Rëndësia ekonomike e pronës.
<b>Java e shtatë:</b>	Pronësia, definimi dhe krijimi i të drejtave pronësore; ndarja e të drejtave pronësore; Fitimi dhe bartja e të drejtave pronësore; Lartësia e kompenzimit të dëmit; Disa probleme të transferimit të të drejtave pronësore: shpronësimi (eksproprioimi); Privatizimi, kostot e transaksionit dhe teorema Coase.
<b>Java e tetë:</b>	E drejta e kontratave dhe ekonomia; Procesi i këmbimit dhe roli ekonomik i së drejtës kontraktore; Kontratat, ligjet dhe ndërmarrjet; Këmbimi, kontratat dhe tregu; Kostot transaksionale dhe strukturat e tregut; Tregu, kontratat jo standarde dhe kompania; Prona dhe liria ekonomike.
<b>Java e nëntë:</b>	Ligji i neglizhencës (paku jdesisë), historiku dhe rëndësia; Në cilat raste individët janë neglizhentë dhe si veprohet në shtetet e zhvilluara, Rasti IKEA; Veprimi parandalues i shoqërisë.
<b>Java e dhjetë:</b>	E drejta e kompenzimit; Parandalimi i dëmit; Parandalimi dhe kompenzimi i dëmit; Përkufizimi i përgjegjësisë; Teoria ekonomike e përgjegjësisë; Llogaritja e kompenzimit; Kompensimi për fitimet e humbura; Kompensimi për dhimbjen dhe vuajtjen.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Analiza ekonomike e ligjit; Kostot dhe dobitë nga rregullimi ligjor; Rëndësia e riskut legjislativ; Pse ka rëndësi pajtueshmëria rregullative; Dimensionimi shumëshkallësh & interinstitucional; Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve të masave të propozuara dhe masave ekzistuese.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Hipoteza REM (Rational Economic Man - Homo Economicus); Qasja deskriptive dhe normative analizës ekonomike të së drejtës; Tregu dhe ligji si dhe ndërveprimi në mes tyre.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Shkolla e zgjedhjes publike: politika si biznes; Paradoksi i grupeve të veçanta të interesit; Ciklet politike dhe ndikimi i tyre në zbatimin e ligjit dhe ekonominë.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Zbatimi i ligjit dhe e drejta penale; prevencioni me sanksione monetare; prevencioni me sanksione jomonetare; Teoria ekonomike e së drejtës së krimeve; Teoria ekonomike e krimit dhe dënimit; Pse ndëshkimi parandalon krimin.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Përgaditja për provim final.
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p><b>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;</li> <li>• Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);</li> <li>• Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimin;</li> <li>• Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.</li> </ul>	

***Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:***

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*